



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje të nenit 47, paragrafi (1), pika 20-a) dhe 21) dhe nenit 64-a) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr.110/21, 74/24) dhe nenit 10, paragrafi (6) nga Statuti i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut St. nr. 02-15/IV-1/2011 nga 21.04.2011, V. nr. 02-15/III-4/2012 nga 29.03.2012, V. nr. 02-15/II-10/2016 nga 25 shkurti 2016, V. nr. 02-15/XV-3/2018 nga 27 shtatori 2018 dhe V. nr. 02-15/VII-5/2019 nga 25 korriku 2019, V. nr. 02-15/XIV-1/2022 nga 2 shtatori 2022 dhe nr. 02-32963/8 nga 5 tetori 2023, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për formimin e Komitetit të Auditimit, për përcaktimin e aktiviteteve që janë nga fushëveprimi i tij dhe për përcaktimin e mënyrës së punës së tij

I. Dispozitat e përgjithshme

1. Me këtë vendim të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin në vijim: Banka Popullore) formohet Komiteti i Auditimit (në tekstin në vijim: Komiteti), përcaktohen aktivitetet që janë në fushëveprimin e tij dhe për përcaktuar mënyrën e punës së tij.

Komiteti i Auditimit formohet për shkak të me qëllim të përmirësimit të mëtejme të menaxhimit korporativ në Bankën Popullore dhe për forcimin e proceseve të kontrollit në kryerjen e veprimtarive dhe detyrave të tij ligjore.

II. Aktivitetet dhe fushëveprimi i punës së Komitetit

2. Komiteti, duke mbikëqyrur politikat kontabël dhe raportimin financiar të Bankës Popullore, vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e procesit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare të Bankës Popullore dhe përshtatshmërinë e përgjithshme të shpalosjeve përkatëse. Për këtë qëllim, Komiteti:

- i ndjek ndryshimet më të rëndësishme në politikat kontabël dhe kornizën e raportimit financiar në Bankën Popullore;
- shqyrton pasqyrat financiare vjetore të Bankës Popullore dhe llogarinë vjetore para miratimit të tyre nga Këshilli i Bankës Popullore;
- në takim të përbashkët me auditorin e jashtëm, drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e Drejtorisë së Financës, Kontabilitetit dhe Kontrollit, kryeauditori i brendshëm, këshilltar i guvernatorit me njohuri/ekspertizë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (në tekstin e mëtejme: SNRF) i shtjellon: pasqyrat financiare të përgatitura nga aspekti i: përshtatshmërinë e zbatimit të politikave kontabël, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve shpjeguese përkatëse, vështirësitë dhe rregullimet më të rëndësishme gjatë auditimit, si dhe mospajtueshmërinë dhe mosmarrëveshjet eventuale të auditorit të jashtëm me menaxhmentin e Bankës Popullore, si dhe Letrën/Raportin drejtuar menaxhmentit të Bankës Popullore për qëllime të brendshme me vlerësimin e kontrolleve të brendshme, proceset e biznesit dhe çështjet e kontabilitetit, dobësitë dhe mangësitë e konstatuara, duke përfshirë sistemet e informacionit për regjistrat kontabël;

- shqyrton raportin e auditorit të jashtëm për pasqyrat financiare të përgatitura dhe përcakton nëse ato janë në pajtim me SNRF-në;
- i jep mendim Këshillit të Bankës Popullore për pasqyrat financiare vjetore të propozuara të audituara dhe për llogaritë vjetore të Bankës Popullore;
- mbikëqyr zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditori i jashtëm dhe shqyrton njoftimet periodike nga njësitë organizative në Bankën Popullore për gjendjen e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i jashtëm.

3. Komiteti e ndjek procesin e përzgjedhjes dhe punën e shoqërisë së pavarur të auditimit dhe bashkëpunon me të për auditimin e pasqyrave financiare të Bankës Popullore, për të gjitha çështjet kryesore që dalin nga auditimi dhe çdo dobësi materiale në kontrollet e brendshme të Bankës Popullore të identifikuar nga shoqëria e auditimit në lidhje me procesin e raportimit financiar, gjatë të cilës:

- mbikëqyr procesin e prokurimit të shërbimeve të auditimit të jashtëm dhe vlerëson nëse është në pajtim me Politikën për zgjedhjen e kompanisë për auditim të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- paraqet mendim në Këshill për propozimin për përzgjedhjen/mospërzgjedhjen e shoqërisë së auditimit të jashtëm;
- rishikon qëllimin, qasjen dhe planin e punës së auditimit të jashtëm, duke përfshirë koordinimin me auditimin e brendshëm;
- një herë në vit kontrollon pavarësinë e funksionimit të shoqërisë së auditimit dhe auditorëve të jashtëm të autorizuar, për të cilin para fillimit të auditimit kontrollon nëse janë dorëzuar deklaratat e pavarësisë;
- vlerëson çdo vit punën e auditorëve të jashtëm dhe raporton për punën e tyre në Raportin Vjetor të Komitetit të Auditimit. Vlerësimi i punës së auditorëve të jashtëm i referohet mënyrës së kryerjes së auditimit, harmonizimin e tij me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, cilësinë dhe hapjen në komunikim me auditorët e jashtëm, pavarësinë e shoqërisë së auditimit dhe auditorëve të autorizuar, objektivitetin e tyre dhe zbatimin e skepticizmit profesional, si dhe nëse burimet e angazhuara janë të mjaftueshme;
- në rast se performanca e auditorit të jashtëm vlerësohet si e pakënaqshme, Komiteti do të përcaktojë dhe do t'i rekomandojë Këshillit të Bankës Popullore që të ndër marrë veprime, e cila mund të përfshijë një bisedë me auditorin e jashtëm për të zgjidhur çështjet që lidhen me kryerjen e auditimit, si dhe për zëvendësimin e anëtarëve të grupit të auditimit;
- shqyrton arsyet e përfundimit të mundshëm të kontratës dhe i paraqet mendim Këshillit të Bankës Popullore për zgjidhjen e kontratës.

4. Komiteti i mbikëqyr efikasitetin dhe efektivitetin e punës së auditimit të brendshëm duke mbikëqyrur punën e tij. Për këtë qëllim:

- shqyrton aktet e brendshme të Bankës Popullore që rregullojnë punën e auditimit të brendshëm dhe sigurohet se është vendosur në mënyrë të rregullt në organizimin e Bankës Popullore dhe i paraqet mendim Këshillit të Bankës Popullore për ndryshimin e akteve të brendshme;
- rishikon programin e punës së auditimit afatmesëm dhe vjetor dhe ndryshimet e mëdha në program, përpara miratimit të tyre nga Këshilli, dhe sigurohet që ato përmbajnë fushat kryesore nga aspekti i rreziqeve;
- rishikon aktivitetet dhe burimet e auditimit të brendshëm dhe sigurohet që nuk ka kufizime të pajustificuara në funksionimin e auditimit të brendshëm;

- kontrollon efektivitetin e auditimit të brendshëm, duke përfshirë harmonizimin e funksionimit të tij me Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, të cilat janë pranuar si standarde për funksionimin e auditimit të brendshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- shqyrton raportet gjashtëmujore dhe vjetore për funksionimin e auditimit të brendshëm, gjetjet dhe rekomandimet e rëndësishme të dhëna nga auditimi i brendshëm, si dhe zbatimin e tyre;
- zhvillon takime pune me shefin e auditorit të brendshëm për të shqyrtuar të gjitha çështjet që Komiteti ose auditimi i brendshëm mendon se janë rishikuar bashkërisht.

5. Komiteti e mbikëqyr funksionimin e sistemit të kontrolleve të brendshme dhe kuadrin e menaxhimit të rrezikut për të cilin:

- duhet të jetë në dijeni të mekanizmave të kontrollit të zbatuar që i referohen, mbi të gjitha, sigurisë dhe kontrollit të sistemit të informacionit, kontrollit të miratimit të të dhënave të kontabilitetit, si dhe kontrollit të pajtueshmërisë së funksionimit me rregulloret;
- të kontrollojë nëse rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm zbatohen në punën e Bankës Popullore;
- shqyrton raportet për menaxhimin e rrezikut operacional të Bankës Popullore.

6. Komiteti e mbikëqyr përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për harmonizimin e veprimeve me rregulloret dhe efektivitetin e procesit të mbikëqyrjes së harmonizimit në nivel të Bankës Popullore, për të cilën është e nevojshme:

- të informohen për rezultatet e procesit të mbikëqyrjes për çdo shembull mosharmonizimi në fushat e përgjegjësisë të Komitetit në pajtim me këtë vendim;
- të rishikojë gjetjet nga auditori shtetëror ose agjenci të tjera rregullatore.

7. Komiteti, në kryerjen e veprimtarive të saj:

- me kërkesë të Këshillit të Bankës Popullore, në kuadër të kompetencave të Komitetit, kryen edhe punë të tjera lidhur me këtë vendim;
- nëse është e nevojshme, shqyrton përshtatshmërinë e këtij vendimi dhe fillon rregullimin e duhur të tij;
- kryen inspektim vjetor, nëse janë përmbushur detyrat e përcaktuara në këtë vendim;
- kryen vetëvlerësim të punës së Komitetit dhe anëtarëve të tij, të paktën një herë në vit.

8. Komiteti e njofton Këshilli i Bankës Popullore në rast të lëshimeve ose parregullsive të konstatuara në punën e Bankës Popullore ose bën sugjerime për përmirësimin e punës.

9. Komiteti është i detyruar të paraqesë raport vjetor për punën e tij deri te Këshilli i Bankës Popullore lidhur me aktivitetet që kryen, problemet me të cilat has dhe rekomandimet që bën.

Përmbledhja e Raportit Vjetor për punën e Komitetit, pa të dhëna individuale, është publikuar në faqen e internetit të Bankës Popullore.

10. Për zbatimin e veprimtarive të Komitetit të parashikuara në këtë kapitull, Komiteti ka të drejtë:

- të kërkojë nga menaxherët taktikë dhe strategjikë raporte, të dhëna dhe informacione të nevojshme për kryerjen e duhur të përgjegjësisë të tij;
- të mbajë takime me personat përgjegjës për proceset e kontrollit në Bankën Popullore dhe me auditorët e jashtëm.

III. Mënyra e punës së Komitetit

11. Komiteti punon në seanca, të cilat mbahen të paktën katër herë në vit.

Puna e Komitetit rregullohet më hollësisht me Rregulloren e punës, të cilën e miraton kryetari i Komitetit.

IV. Dispozitat përfundimtare

12. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Vendimi për themelimin e Komiteti të Auditimit dhe përcaktimin e fushëveprimit të tij pushon së vlefshmi V nr. 02-15/XIX-1/2021 nga 3 dhjetori 2021.

13. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Бр./Nr. 02-23460/8
26 јуни/qershor 2024 година
Скопје /Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска